



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 34
Prishtinë, më 18.01.2012, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu dhe Rasim Demiri.

Mungoi: Emin Gërbeshi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Raportimi i Drejtorit të Policisë së Kosovës para Komisionit

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisioni, ky takim është thirrur në bazë të Raportit të dërguar nga Drejtori i Policisë së Kosovës, për të bërë analizat dhe për të parë funksionimin e Policisë së Kosovës në të gjitha segmentet e saj si dhe sugjerimet që mund të dalin nga Komisioni për këtë Raport.

Në këtë takim nuk do të jenë të pranishme mediat, pasi ky takim ka të bëjë më shumë me çështje operative dhe të statistikave. Por ky raport është bërë publik dhe mediat kanë mundësi për ta parë

atë. Në konsultim me Drejtorin e Policisë së Kosovës do të shohim nivelin e funksionimit të Policisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit shtoi që për Rend të ditës kemi Raportin e Drejtorit të Policisë së Kosovës, por mund të shtrohen edhe çështje të tjera, por fokusi do të jetë tek Raporti i Policisë së Kosovës, gjithashtu theksoi që pas konsultimit me të gjithë anëtarët e Komisionit nga java tjetër afërsisht 25.01.2012 preferojmë që ta kemi një Raport nga Policia e Kosovës për ngjarjet e 14 janarit, 2012 tek Dheu i Bardhe dhe Merdarë ku në bazë të këtij Raporti ne si Komision do ti japim vlerësimet tona. Por kjo çështje do të diskutohet kur ta kemi Raportin nga Policia e Kosovës.

Drejtori i Policisë së Kosovës- Theksoi që pasi kemi dërguar tek ju Raportin përmbledhës për vitin 2011, përmes së cilit kemi pretenduar të pasqyrojmë punën një vjeçare të Policisë së Kosovës, para se të filloj elaborimin e Raportit do të doja të shpreh një shqetësim personal sa i përket mbajtjes dhe mirëmbajtjes së të dhënave për Policinë e Kosovës, një mangësi që e ka përcjell Policinë e Kosovës që në fillimet e saj, pasi në bazë të këtyre statistikave bëhet vlerësimi i arritjeve brenda një viti. Sipas tij deri tani nuk është bërë sa duhet në avancimin e teknologjisë informative për një menaxhim adekuat të të dhënave.

Në Policinë e Kosovës kemi rreth tetë projekte për avancimin e teknologjisë informative si një segment kyç, jo vetëm për mirëmbajtjen e statistikave por edhe në avancimin e punës së përgjithshme të Policisë së Kosovës në sektor dhe fusha të caktuara, prandaj ju kërkoj mirëkuptimin nga ana juaj për saktësinë e këtyre statistikave, pasi me një përkushtim maksimal bashkë me stafin do të eliminojmë këtë mangësi e cila e ka përcjell Policinë e Kosovës. Në këtë drejtim ne kemi një mbështetje të madhe nga miqtë ndërkombëtarë (Komisioni Evropian) si dhe ICITAP-i amerikan që ka mbështetur projekte për avancimin e kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative.

Siç e dimë Policia e Kosovës është e organizuar në dy nivele, në nivelin lokal dhe atë qendror. Niveli lokal mbulon Stacionet Policore dhe nën Stacionet dhe Drejtoritë Rajonale ndërsa niveli qendror mbulon Drejtorinë e përgjithshme me departamentet dhe shtyllat përkatëse. Policia e Kosovës funksionon në kuadër të misionit dhe vizionit që ka. Nga viti i kaluar ne kemi paraqitur planin strategjik zhvillimor 2011-2015 dhe në kuadër të këtij plani janë të përcaktuara shtatë objektiva strategjike, që do të thotë se raporti i punës i Policisë së Kosovës është bazuar në këto shtatë objektiva.

Fokusi kryesor ka qenë në ngritjen e kapaciteteve sidomos në tendencën e ndryshimit të qasjes policore duke tentuar për ta ndryshuar konceptin e vjetër apo siç njihet në gjuhën profesionale vënien në dispozicion të kapaciteteve tona në formën parandaluese, ndryshe nga ajo klasike që ka qenë reaguese. Nga viti 2011 kemi bërë përpjekje që Policia e Kosovës të paraqitet në masën parandaluese, në kuadër të këtij objektivi kemi hartuar një dokument strategjik i cili quhet Metodologjia e re e punës, i cili synim ka evitimin e mangësive të Policia së Kosovës, sigurinë e qytetarëve kudo që janë.

Ky dokument kaq i rëndësishëm nuk mund të realizohet për një kohë të shkurtër, pasi mënyra e funksionimit të Policisë së Kosovës për dymbëdhjetë vite ka qenë e konceptit klasik të reagimit, ndërsa tani nevojitet një qasje më ndryshe. Ky projekt kërkon financim për trajnim, edukim, specializim si dhe një bashkëveprim si brenda Policisë së Kosovës ashtu edhe me subjekte dhe institucione të tjera.

Kemi bërë shumë punëtori në kuadër të Policisë së Kosovës duke përfshirë edhe Këshillat Komunale, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Drejtësisë me qëllim të koordinimit të veprimeve të nevojshme kurdoherë që kërkohet veprim i përbashkët, por barra më e madhe

mbetet tek Policia e Kosovës për arritjen e kësaj objektive e cila kërkon kohë për tu realizuar e plotë, për qëllimin e parandalimit të situatave të ndryshme. Në Raportin e Policisë për vitin 2011 është përfshirë një Rekomandim për ndryshimet që duhet bërë në Policinë e Kosovës në konceptin e policimit.

Projekt tjetër madhor është ai i Policisë së udhëhequr nga Inteligjenca, ky projekt nuk është realizuar plotësisht për arsye objektive, gatishmëria ekziston nga strukturat e Policisë së Kosovës, ky projekt varak kryesisht nga mbështetja e teknologjisë informative. Ne jemi të fokusuar që ky aspekt të jetë segment kyç i Policisë së Kosovës sipas vizionit strategjik. Për këtë qëllim janë realizuar trajnime për stafin, mbështetje e ofruar edhe nga OSCE. Qëllimi jonë është që të jemi sa më afër dhe në mbështetje të qytetarit, por shpesh çështja e trajtimit inteligjent të informacionit ende nuk kuptohet në mënyrën parimore në opinion, dhe për këtë qëllim në projekt është përfshirë edhe aspekti i ndihmës për qytetarët për ta ndihmuar që të kuptojnë këtë mision.

Për të arriturat në luftimin e krimit të organizuar të përfshira në Raport, Policia e Kosovës që nga 2008 ka të përfshira segmente të veçanta që merren me luftimin e krimit të organizuar dhe për këtë fushë është bërë avancimi nga drejtori në departament në mënyrë që të kryej funksionin më mirë ku kemi përfshirë drejtoritë e caktuara që mbulojnë sektor të caktuar brenda gjithë territorit të Republikës së Kosovës. Gjithashtu ne kemi strategjitë nacionale për fushat e caktuara të cilat janë, strategjia e luftimit të krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, trafikimit të narkotikëve, terrorizmit, parandalimit të krimit etj.

Statistikat e përfshira në Raport në kuadër të Departamentit për krime të organizuara, do të përmend statistikën ku janë iniciuar 566 raste (referimi në Raportin e Policisë të 2011) kallxime penale për persona të dyshimtë për krim të organizuar 352, persona të arrestuar për veprime të kundërligjshme 790, narkotikë të konfiskuar, gjithashtu në bashkëpunim me Departamentin kundër krimit të organizuar dhe Drejtorive përkatëse janë shkatërruar katër grupe kriminale që vepronin në territorin e RKS-së.

Drejtoria kundër trafikimit të qenieve njerëzore është treguar mjaft e suksesshme dhe mund të shërbej si model për qasjen operacionale që ka pasur në bashkëpunim edhe me faktorët ndërkombëtar siç është EULEX-i. I referohemi Raportit, viktimat e trafikuar 34, të asistuar 29, operacione të realizuara 549 dhe persona të kërkuar të profilin të lartë, përgjegjës ndaj institucioneve të Drejtësisë janë 10 të arrestuar, këto të dhëna janë tregues i një pune të mirë të kësaj Drejtorie.

Drejtoria për luftimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit, kanë qenë 527 raste të hapura, të arrestuar 219 persona, 96 operacione të realizuara dhe të gjitha veprimet e kundërligjshme të cilat kanë qenë subjekt i hetimeve në këtë drejtori llogaritet afër 28 milion euro dëm buxhetit të Kosovës si dhe subjekteve të caktuara. Konsideroj që Shtylla e hetimeve për luftimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit është treguar e suksesshme me përkushtimin e hetuesve dhe menaxhmentit të Policisë.

Në pjesën e Hetimeve kemi edhe Njësitë rajonale që janë pjesë integrale e Drejtorive rajonale që shtrihen edhe në nivel të stacioneve policore, këto segmente hetojnë vepra që hetohen në bashkëveprim me Prokuroritë komunale dhe të qarkut, sipas përkatësisë vendore duke shënuar sukses në obligimet që kanë pasur.

Policia Kufitare ka shënuar një sukses në vitin 2011, ne kemi alokuar stafin e nevojshëm në Policinë Kufitare në kuadër të shtyllës së policisë kufitare sipas kritereve të përcaktuara. Në vitin 2011 kemi arritur që të marrim përgjegjësinë e Vijës së gjelbër, me dy shtetet fqinjë dhe kjo përbën sukses jo vetëm për Policinë e Kosovës por edhe për Institucioneve të Kosovës, ku

mekanizmat ndërkombëtar të sigurisë ja kanë besuar ruajtjen e kufirit shtetëror Policisë së Kosovës.

Kemi disa vështirësi në raport me sistemin aktual i cili zbatohet në Policinë Kufitare. Komisioni Evropian ka financuar projektin i cili shtrihet në Policinë Kufitare dhe në aeroport, nga takimet që kam pasur me përfaqësues të Komisionit Evropian kemi rënë dakord për eliminimin e defekteve të sistemit në favor të sigurisë nacionale. Me ndihmën e tyre kemi arritur të sigurojmë edhe pajisje shtesë për Policinë Kufitare.

Duke përfunduar këtë pjesë të prezantimit theksoi që, supozoj që kam mbuluar pjesën më esenciale të Raportit për vitin 2011, dhe shprehi gatishmërinë për pyetje nga ana e anëtarëve të Komisionit.

Kryetari i Komisionit- Ne sot i referohemi Raportit zyrtar dhe atij publik të publikuar më 27 dhjetor 2012, ku ka shumë për tu diskutuar.

Në Raportin zyrtar te pjesa ku i kushtohet Njësisë së Inspektimit dhe Auditimit, po i referohem Raportit që thotë: ka pasur auditim të brendshëm dhe gjithsej janë 188 rekomandime nga të cilat 65 janë implementuar, 69 pjesërisht dhe 31 rekomandime nuk janë implementuar fare nga departamentet dhe drejtoritë përkatëse, ndërsa në tabelë ceket se Drejtoria e Prokurimit nuk ka pasur auditim të brendshëm, pra zero. Nga referimi i këtyre të dhënave mund të krijohen keqkuptime.

Drejtorja e standardeve profesionale, në Raport thuhet që është shqetësuese rritja e numrit total të rasteve të hetimeve të brendshëm ku këtë vit raportohen 1914 raste, krahasuar me vitin paraprak ku kanë qenë në total 892 raste pra kemi një rritje për 1022 raste më shumë, kjo rritje shqetësimin se brenda Policisë së Kosovës niveli i disiplinave respektimit të procedurave, rregullave shënon rënie drastike për më shumë se 100%, prandaj nga ana juaj kërkojmë ndonjë koment në lidhje me këtë.

Drejtori i Policisë- Shtoi se sa i përket disiplinës brenda Policisë së Kosovës dy vitet e fundit ka pasur disa probleme, ju e dini që ka hy në fuqi Ligji i Inspektoratit Policor i cili në një periudhë të caktuar është marrë edhe me disiplinën e brendshme të Policisë. Me ndryshimet që i janë bërë Ligjit të Inspektoratit Policor përgjegjësia disiplinore i ka kaluar Policisë së Kosovës dhe gjatë kësaj periudhe ka qenë një boshllëk në ndarjen e përgjegjësi se çka konsiderohet disiplinë e brendshme dhe mandat i kujt është. Pa dashur të kritikoj, ish-Drejtori i Policisë së Kosovës ka shuar disa Komisione funksionale që janë marrë me trajtimin e disiplinës.

Pas marrjes së pozitës Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, kam riaktivizuar këto Komisione dhe pikërisht është koha e amullisë gjatë së cilës nuk kanë funksionuar këto Komisione, janë krijuar rastet enorme në kuadër të Drejtorisë së Standardeve Profesionale, edhe pse janë marrë me këto raste ka munguar mekanizmi mbikëqyrës si instancë më e lartë e cili është dashur të marrë vendime.

Nga vendimi që kam marrë për ri-aktivizimin e këtyre Komisioneve, gjendja e disiplinës në Policinë e Kosovës është përmirësuar shumë, dhe të gjitha rastet e grumbulluara kanë filluar të trajtohen nga Drejtoria e Standardeve Profesionale, tani çdo gjë është e qartë dhe e bazuar në Ligj. Kemi pasur takime shtesë me menaxhmentin e Policisë duke përfshirë Komandantët e Stacionit, Drejtorët Rajonal në mënyrë që të kuptohet se mandat i kujt është disiplina brenda Policisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Duke e ditur që ju jeni në pozitën e Drejtorit të Policisë prej gjashtë muajsh do të ju sugjeronim si Komision që të mësoni nga gabimet e së kaluarës në mënyrë që mos të përsëriten.

Drejtori i Policisë- Pajtohem që disiplina është esenciale për funksionimin e Policisë së Kosovës për arritjen e rezultateve, për këtë arsye kam qenë shumë i vendosur që Policia e Kosovës të ketë mekanizma të qartë ashtu siç ligji e parashikon.

Fatmir Xhelili- Parashitroi pyetje për Drejtorin e Policisë.

Lëndët që i ka udhëhequr Inspektorati Policor, a do të kalojnë komplet në standarde apo do të ketë obligim Inspektorati ti zgjidh ato lëndë të cilat kanë qenë obligim i tyre deri në ndërrimin e kompetencave?

Drejtori i Policisë- Gjithsej kanë qenë 360 lëndë në menaxhimin e Inspektoratit Policor dhe këto shifra e kanë rritur përqindjen e disiplinës brenda PK, me ndarjen e përgjegjësive ligjërish këto lëndë kanë kaluar te Policia e Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Drejtoritë Rajonale, të zbulueshmërisë së rasteve të krimit të organizuar të përfshira në Raport, kjo pikë është gjithashtu shqetësuese. Kemi 9.6% rënie të zbulueshmërisë, vetëm në rajonin e Gjilanit ka ngritje. Kjo duhet të merret parasysh pasi pasqyra e veprimit të një Policie është në terren, atje ku vepron Policia. Vet fakti që kemi rënie të zbulueshmërisë është tregues që nuk i kemi punët mirë.

Drejtori i Policisë- Shtoi që nëse e marrim numrin e rasteve të krimeve të paraqitura për këtë vit kemi rënie, por pajtohem që kemi rënie në fusha të caktuara në luftimin e krimit në kuadër të aktiviteteve policore. Në këtë kontekst jemi të përgjegjshëm për obligimet ligjore që i kemi dhe kemi një angazhim të plotë, sidomos nga njësit e specializuara për hetimin e krimit të organizuara. Koncepte dhe modelet e reja në kuadër të projekteve që kemi, kanë qëllimin e një qasje proaktive në terren, marrje të informacionit relevant në kohë.

Kryetari i Komisionit- Te shtylla e Policisë Kufitare kemi rritje te veprave penale për 16 %, kundërvajtjet në rendin publik për 38%, në bazë të këtyre të dhënave duket që kemi një rritje dhe kjo është shqetësuese, dhe për këtë do të donim një sqarim nga Drejtori i Policisë.

Drejtori i Policisë- Qasja strategjike që do të kemi ndaj të gjitha problemeve do të jetë një qasje parandaluese që do të thotë se policët e Stacioneve Policore, Patrullat Policore të jenë sa më shumë në terren. Ne kemi bërë një ndarje operationale të zonave përgjegjësisë, pra policë të caktuar mbulojnë zona të caktuara, ofrimi i ndihmës për qytetarët bashkëpunimi me ta, trajtimi i problemeve dhe shqetësimeve që mund të kenë qytetarët. Kjo qasje do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në terren, dhe nëse gjithçka shkon sipas planit Raporti për vitin 2012 do të jetë me shumë përparime në këtë fushë.

Kryetari i Komisionit- Në Drejtorin për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit, krahasuar me 722 raste sa kanë qenë në vitin 2010 në vitin 2011 shohim 143 raste që do të thotë 80% raste më pak nën hetime, kjo tregon nivelin e ulët të angazhimit.

Drejtori i Policisë- Shtoi se Policia e Kosovës nuk qëndron mirë me menaxhimin e statistikave dhe bëri të ditur se kjo çështje duhet të dihet edhe nga opinioni publik në mënyrë që mos të krijohen keqkuptime.

Fatmir Xhelili- Parashitroi pyetje për Drejtorin e Policisë.

A ka përfunduar projekti i lidhjes së bazës së të dhënave dhe sistemeve të teknologjisë informative me bazën e të dhënave të Drejtorisë së analizës së krimit?

Drejtori i Policisë- Akoma jemi në proces të kësaj lidhjeje. Gjatë misionit të UNMIK-ut deri në vitin 2005, shtrirja e sistemit informativ të Policisë së Kosovës ka qenë deri në Stacion Policor, UNMIK-u në vitin 2005 me një vendim arbitrar e ka bërë shkëputjen e sistemit dhe që nga ajo kohë menaxhimi i statistikave të Policisë së Kosovës ka pasur probleme. Projektet që kemi në plan kanë si qëllim edhe përmirësimin e bazës së të dhënave, ndërlidhjen me institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit si dhe avancimin e teknologjisë informative si parakusht për rritjen e kapaciteteve të Policisë së Kosovës.

Kryetari i Komisionit- Referuar në Raportin e Policisë për vitin 2011, pjesa që i kushtohet antikorruptionit. Ne kemi tani Departamentin antikorruption i krijuar me vendim të Kryeministrit.

Shikuar në statistika nga 47 raste sa kanë qenë të regjistruara vetëm 7 raste përfundojnë me aktakuzë. Do të sugjeroja që ky Departament ti hiqet, dhe kompetenca të kaloj komplet në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pasi mekanizmat e dyfishtë bënë që askush mos ta marrë përgjegjësinë.

Drejtori i Policisë- Mendoj që mekanizmat të tillë janë në funksion të arritjeve pozitive, ne kemi angazhuar 38 hetues më të mirë të cilët në bashkëpunim me prokurorët trajtojnë të gjitha rastet. Në momentin kur ushtrohet një kallxim penal dhe shtrohet në Prokurorinë përkatëse aty përfundon mandati i Policisë.

Rexhep Selimi- Sa i përket Departamentit antikorruption, në Raportin e 2011 është cilësuar si mekanizëm i suksesshëm. Do të donim që të kishim edhe opinionin tuaj si Drejtor i PK për këtë. A mendoni se ka qenë i suksesshëm, a duhet të vazhdoj tutje veprimtarinë ky Departament?

Fatmir Xhelili- Parashtroi pyetje për Drejtorin e Policisë.

A keni instaluar në shtyllën e hetimeve të krimit, një mekanizëm të vlerësimit për rastet e dyshimeve të bazuara me prova para Prokurorit e të cilat janë kërkuar nga ai, apo ato të cilat i ka prezantuar Prokurori para Gjykatësit të procedurës paraprake, e janë refuzuar nga ai?

A ka ndonjë mekanizëm të tillë për vlerësimin real të evidencave(fakteve) e që përmes punës së tyre të prezantojnë gjendjen reale, e cila punë do ti referohej dyshimeve për korrupsion eventuale në këto hallka të sistemit?

Ganimete Musliu- Parashtroi pyetje për Drejtorin e Policisë.

A mund të garantoni që problemi i menaxhimit të statistikave mund të zgjidhet për një periudhë sa më të shkurtër?

Drejtori i Policisë- Sa i përket nevojës së ekzistimit të Departamentit antikorruption mendoj se është i nevojshëm dhe vazhdimësia e punës në këtë Departament është e nevojshme, pasi këta mekanizma ligjor duhet që përmes punës së tyre të prezantojnë gjendjen reale e cila i referohet dyshimeve për korrupsion.

Në përgjigjeje e pyetjes së z. Fatmir Xhelili, Policia e Kosovës në koordinim me Prokurorin dhe Gjyqtarët e procedurës paraprake, çdo herë kur është e nevojshme analizojnë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me një rast të caktuar. Hetuesi i rastit është ai i cili angazhohet në procedurën vlerësuese para asaj hetimore me qëllim që të sigurohemi se të gjitha informacionet, faktet do të shërbejnë sipas procedurës ligjore.

Dhe në përgjigjeje të pyetjes së znj. Ganimete Musliu, për mirë menaxhimin e statistikave, do të bëjë përpjekje maksimale për reduktimin e këtyre mangësive.

Kryetari i Komisionit- Theksoi që të dy Raportet e paraqitura nga Policia e Kosovës, Raporti zyrtar dhe ai publik kanë një diferencë të madhe në përpunimin e të dhënave. Raporti publik nuk është i përpunuar dhe ka një mospërputhje logjike dhe precizim të saktë me të dhënat që janë përfshirë në Raport. Këto gabime nuk duhet të tolerohen pasi jemi institucione përgjegjëse për çështje të Sigurisë.

Ne si Komision për kontroll demokratik të institucioneve të Sigurisë, na intereson imazhi i këtyre institucioneve, besueshmëria prandaj duhet të jemi të kujdesshëm ndaj këtyre gjërave. Mundohuni që strategjitë të implementohen, mos të mbesin në letër, çështja e statistikave të përmbushet pasi kjo gjë kërkohet edhe në Raportin e Progresit në mënyrë që të tregojmë një pasqyrë të mirë të funksionimit të PK. Prandaj në të ardhmen do të preferonim që të kishim Raporte më precize. Gjithashtu ne kemi kërkuar Raportin për gjendjen në Veri të Kosovës bazuar në Planin e veprimit të 25 korrikut 2011 si dhe një Raport të ngjarjeve të 14 janarit 2012.

Rexhep Selimi- Analiza e bërë për Raportin e 2011 është e bërë në emrin e gjithë Komisionit, kemi vërejtje dhe pakënaqësi mbi realizimin e këtyre Raporteve, por kërkimi i tyre dhe analizimi i tyre është kryerje e funksionit të Komisionit si institucion mbikëqyrës për institucionet e Sigurisë. Ne si Komision presim që nga java e ardhshme 25 janar 2012 të procedohet kërkesa jonë për të pasur një Raport profesional dhe objektiv për ngjarjet e 14 janarit 2012.

Drejtori i Policisë- Dua të ju siguroj edhe një herë që ne si Institucion i zbatimit të ligjit me gjithë potencialin tonë do të jemi në funksion të forcimit të këtij institucioni dhe për çdo gjë që konsiderohet shqetësuese për opinionin do ta trajtojmë me konsideratën më të madhe në mënyrë objektive. Ju falënderoj për kohën e rezervuar për të diskutuar për Raportin e Policisë së Kosovës të vitit 2011 dhe ju ftoj në zyrën time për të diskutuar për të gjitha çështjet e Sigurisë.

Kryetari i Komisionit- Në mbyllje të takimit falënderoi Drejtorin e PK për raportimin në Komisionin për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së. Njoftoi që Ligji për Policinë e Kosovës në mbledhjen e radhës në Parlament mund të kalojë. Të kemi një Ligj me një strukturim më të plotë, në mënyrë që të kemi një Polici të standardeve ndërkombëtare dhe aso çfarë populli i Kosovës e meriton.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi